



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERVBAL ¹ (i përmbledhur)

Tiranë, më 10.07.2020, ora 13:00

Drejton mbledhjen
Vitore Tusha – zv/Kryetare e Këshillit

Rendi i Ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të datave 03.02.2020, 05.02.2020, 06.02.2020 dhe të mbledhjes së fundit të datës 30.06.2020.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 4, datë 11.03.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar”.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 5, datë 02.04.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar”.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 1, datë 08.02.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për miratimin e rregullores së brendshme për funksionimin e Këshillit për Emërime në Drejtësi”, i ndryshuar”.

5. Të tjera.

Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------|---------------|
| 1. Vitore Tusha | (zv/kryetare) |
| 2. Fiona Papajorgji | (anëtare) |
| 3. Arta Marku | (anëtare) |
| 4. Miranda Andoni | (anëtare) |
| 5. Fatjona Memçaj | (anëtare) |

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja “d”, neni232 pika 2, neni 242 shkronja “c”) dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

- | | |
|------------------------|------------------------|
| 6. Saida Dollani | (anëtare) |
| 7. Ludovik Dodaj | (anëtar) |
| 8. Arjan Qafa | (anëtar) |
| 9. Marsida Xhaferllari | (anëtare zëvendësuese) |
| 10. Bilbil Mete | (anëtar zëvendësues) |
| 11. Nazmi Troka | (anëtar zëvendësues) |

Merr pjesë si vëzhguese e përhershme:

- 1. Zonja Erinda Ballanca, Avokate e Popullit.**

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguara në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

- 1. Zoti Bledar Dervishaj dhe zonja Katrin Treska**, përfaqësues me autorizim të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.
- 2. Zonja Mimoza Arbi**, përfaqësuese me autorizim e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

HAPET MBLEDHJA

Ora 13:00

Vitore Tusha, pasi deklaroi të hapur mbledhjen e thirrur sipas rendit të ditës që është komunikuar, verifikoi prezencën e të gjithë anëtarëve, si dhe anëtarëve zëvendësues.

Ajo vë në dukje se janë të pranishëm edhe Avokati i Popullit, personalisht, përfaqësuesit e Presidentit të Republikës, zoti Bledar Dervishaj dhe zonja Katrin Treska, përfaqësuesja e kryetarit të Kuvendit, zonja Mimoza Arbi, ndërkohë që nuk marrin pjesë të ftuarit përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare që kanë mbështetur me konsulencë procesin e hartimit dhe të miratimit të akteve nënligjore të KED-së, të cilët në një komunikim me *e-mail* kanë propozuar zhvillimin e mbledhjes *online* për shkak të rritjes të numrit të të sëmurëve me Covid-19, duke propozuar edhe mbështetjen e tyre teknike për këtë qëllim. Por koha e shkurtër, pamundësia teknike dhe interpretimi i dispozitës, që parashikon që mbledhjet janë të mbyllura, nuk e lejuan një gjë të tillë.

Zonja Tusha kalon në pikën e parë të rendit të ditës, që është miratimi i procesverbaleve, të cilat u janë dërguar të gjithë anëtarëve. Procesverbalet miratohen nga të pranishmit pa vërejtje.

Çështja pasuese e rendit të ditës është propozimi për një ndryshim në vendimin nr. 1, datë 08.02.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për miratimin e rregullores të brendshme për funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, pasi zonja Memçaj do të largohet për shkak të vendimmarrjes të mëparshme të kryetarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi 2019. Zonja Tusha shpjegon arsyen e spostimit të çështjes në rendin e ditës, pasi në momentin e formulimit të rendit të ditës nuk e kishte të qartë pjesëmarrjen apo jo të zonjës Memçaj.

Saida Dollani e merr fjalën për të bërë prezantimin e relacionit paraprak. Në mbledhjen e parafundit është diskutuar që në përputhje me ligjin për organet kolegjiale, kryetari duhet të votojë i fundit. Ky është një parashikim ligjor për të cilin nuk është rënë dakord në fakt në mbledhjen e parafundit, por u mor përsipër që ta risillnin ndoshta me argumente më të theksuara për të vënë edhe njëherë theksin që është shprehimisht e parashikuar në ligj dhe për sa kohë që

ligji nr.115/2016 referon për votimin për aq sa është e mundur tek ligji për organet kolegjiale, sugjerohet të ndryshohet pika e cituar, duke votuar kryetari i fundit.

Marsida Xhaferllari e merr fjalën duke sqaruar se “paragrafi i fundit janë dy akte nënligjore me të njëjtën përmbajtje”.

Saida Dollani sqaron se “Grupi i Punës sjell në vëmendje edhe diskutimin e kryer në mbledhjen e datës 06.02.2020, ku nuk është pranuar ndryshimi i rregullave për radhën e shprehjes së qëndrimeve dhe të votimit të kryetarit, por është marrë angazhimi për paraqitjen e propozimeve për këtë çështje në mbledhjet e ardhshme të Këshillit. Nëse kjo çështje merret në shqyrtim nga KED-ja, atëherë nevojitet ndryshimi i vendimit nr. 1/2019 “Për Rregulloren e Brendshme të Këshillit” (neni 16, pika 12), si dhe i vendimit nr. 4/2019 “Për procedurat e verifikimit” (pika 43). Kryetari i Këshillit voton i fundit.”.

Anëtarët dhe anëtarët zëvendësues të Këshillit diskutojnë në lidhje me këtë propozim të grupit të punës, duke vënë në dukje se ky propozim nuk ka të bëjë me rekomandimet e lëna nga opinioni i Komisionit të Venecias, por me një propozim të bazuar në ligjin për organet kolegjiale. Ata shprehën mendimin e tyre në lidhje me faktin që kryetari të shprehë qëndrimin dhe të votojë i fundit, me qëllim që mos të diktojë në vendimmarrjen e Këshillit.

Saida Dollani rithekson se “me reformat që i janë bërë sistemit të drejtësisë, një nga arsytet pse është vendosur të ngrihet ky Këshill, është pikërisht paanshmëria dhe duke parë që përbëhet nga magjistratë. Kjo do të thotë se vota e kryetarit nuk ndikon në psikologjinë votuese të askujt prej anëtarëve. Së dyti, unë jam e bindur që i njoh mirë rregullat, por ndoshta bindja ime nuk qëndron në qoftë se do të ketë një argument tjetër, vota e kryetarit nuk është përcaktuese në kuptimin që vota e tij numërohet dy, pra vota numërohet e barabartë me të të gjithë të tjerëve. Kështu që nuk është përcaktuese, do të ishte nëse do të ndaheshin në barazim, si do të votonte kryetari do të shkonte në, në qoftë se jam e gabuar, por neve, në fakt, na e ka parashikuar rregullorja që kur janë barazim sesi shkon votimi. Kështu që, prandaj e vë akoma theksin që është e mundur të zbatohet ligji mbi organet kolegjiale, duke votuar kryetari i fundit.”.

Erinda Ballanca e merr fjalën duke sqaruar se “qëndrimi i Avokatit të Popullit ka qenë që vota të ishte e para për të mos e ndarë në fund votimin. Ky ka qenë qëndrimi im dhe nga kjo jam nisur, pa pasur në vëmendje parashikimin e shprehur në ligjin për organet kolegjiale. Mendoj se këto rregullore duhen të sillen në përputhje me ligjin për të qenë sa më afër dhe për të treguar që e zbatojmë ligjin me një nivel edhe më të lartë sesa kushdo tjetër për efekt të standardit të zbatimit të ligjit”.

Bledar Dervishaj e merr fjalën shprehet dakord me këtë propozim duke përshëndetur këtë ndryshim të propozuar në Këshill. “Ne e kemi shprehur qëndrimin tonë mbi këtë propozim që në fillim të vitit. Ky propozim vjen në përmirësim të ruajtjes së parimit të balancës dhe mbrojtjes së vendimmarrjes së Këshillit, përmes mosndikimit të votës së Kryetarit në vendimmarrjen e organit kolegjial”. Ndoshta një sugjerim i vogël për përmirësim, do të ishte që të specifikohet “Kryetari i Këshillit dhe/ose Zëvendëskryetari i Këshillit që drejton mbledhjen”, për rastet kur si tani, në mungesë të Kryetarit, kompetencat i ushtron Zëvendëskryetari.

Mimoza Arbi vë në dukje që nuk ka asnjë vërejtje.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve, lidhur me propozimin në vendimin nr. 1/2019 “Për rregulloren e brendshme të Këshillit” (neni 16, pika 12), si dhe propozimin në

vendimin nr. 4/2019 “Për procedurat e verifikimit” (pika 43), për fjalinë “Kryetari i Këshillit voton i fundit.”, ranë dakord që të miratohet. Votoi kundër miratimit të propozimit anëtarja Miranda Andoni. Me 7 vota pro dhe 1 kundër, ky propozim u miratua.

Largohet nga salla e mbledhjes anëtarja Fatjona Memçaj.

Vitore Tusha vijon me rendin e ditës: shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 4, datë 11.03.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar”.

Fjalën për të bërë propozimin paraprak e merr anëtarja e grupit të punës, zonja Saida Dollani, e cila lexon relacionin e përgatitur.

“Më konkretisht:

Pika 41 e vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, propozohet të ketë këtë formulim:

“ Bisedimet e çështjes, si edhe votimi i vendimit bëhen vetëm nga anëtarët e Këshillit. Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në funksion të transparencës dhe besimit të publikut”.

Pika 62 e vendimit nr. 5, datë 02.04.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, propozohet të ketë këtë formulim:

“Bisedimet e çështjes, si edhe votimi i vendimit bëhen vetëm nga anëtarët e Këshillit. Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në funksion të transparencës dhe besimit të publikut.”

Kjo ishte për rekomandimin nr.1.

Vitore Tusha sqaron se rendi i ditës është bërë sipas projektvendimeve.

Saida Dollani vazhdon me rekomandimin nr. 4 **“KED-ja nuk duhet të propozojë kandidatë të cilët nuk e kanë kaluar ende vetingun”.**

“Ky rekomandim i përmendur edhe në pikën 84 të Opinionit, është rrjedhojë e argumenteve të ekspozuara në pikat 78, 79, 80, 81, 82 dhe 83 të të njëjtit akt. Pra, shikohet qartazi që nuk është në pikën 105 dhe një rekomandim i drejtpërdrejtë.

Në vlerësimin e grupit të punës rekomandimi duhet të reflektohet në ndryshimin e këtyre tri pikave 104, 105 dhe 112.

Konkretisht, propozohet që:

- në pikën 104, shprehja “e dhënë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit” të zëvendësohet me shprehjen “përfundimtar të rivlerësimit kalimtar”;
- në pikën 105, pas fjalës “detyrë”, të shtohet shprehja “me vendim përfundimtar”;
- në pikën 112, shprehja “Komisioni i Pavarur i Kualifikimit të ketë dhënë vendim” të zëvendësohet me shprehjen “organet e rivlerësimit të kenë dhënë vendim përfundimtar”.

Ndërsa për sa i përket “kryetari i Këshillit voton i fundit”, kjo u votua. Kështu që, këto janë në lidhje me projektvendimin nr. 4”.

Anëtarët diskutojnë nëse propozimet do t'i shohin një nga një apo të gjitha së bashku.

Anëtarët dhe anëtarët zëvendësues të Këshillit diskutojnë në lidhje me propozimin e grupit të punës që Avokati i Popullit të marrë pjesë në të gjithë procesin në veprimtarinë e Këshillit në funksion të transparencës duke theksuar se gjenden përpara një rekomandimi specifik nga opinioni i Komisionit të Venecias, i cili duhet të pasqyrohet si në pikën 41 të vendimit nr. 4 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Saida Dollani e merr sërish fjalën për të thënë se në këtë rast theksohet roli kushtetues i Avokatit të Popullit, që është vëzhgues. Prandaj duhet pranuar jo vetëm se është rekomandim i Venecias, por se është dhe roli kushtetues i Avokatit që si vëzhgues të jetë pjesëmarrës në veprimtarinë e KED- së.

Marsida Xhaferllari e merr fjalën duke sqaruar se personalisht ka pasur qëndrimin që fjala “si vëzhgues” nuk duhet të qëndronte, por nga diskutimet në grupin e punës dhe meqë Komisioni i Venecias në gjuhën e rekomandimit e cilëson shprehimisht pjesëmarrjen e Avokatit të Popullit si vëzhgues, u soll ky propozim.

Erinda Ballanca vuri në dukje që nuk ka qenë çështja për të cilën ka vajtur në Komisionin e Venecias problematika e Gjykatës Kushtetuese, por në fakt ka qenë një çështje shumë e diskutuar në lidhje me ecurinë e KED-së për vitin 2019 dhe një debat jo i vogël të cilin është përpjekur ta adresojë në mënyrën e duhur për të pasur një kërkesë transparence. “Unë dua të them vetëm një fakt që qëndrimet e Avokatit të Popullit në 99% të rasteve kanë qenë të njëjta me qëndrimet e KED- së. Kjo tregon që nuk ka pasur një problematikë të theksuar brenda nesh, përveç kur ka pasur vendime të Këshillit që kanë qenë veprime individuale procedurale, të cilat u bënë dhe shkak i kësaj problematike dhe nevojës për të marrë opinion nga Komisioni i Venecias. Kështu që për mua, pavarësisht qëndrimit se ligji në dispozitën e tij kur flet për mbledhjet e KED-së, nuk e përmend termin “vëzhgues”, unë nuk kam kundërshtim që ky term të përfshihet.”

Bledar Dervishaj, duke u shprehur dakord me këtë propozim merr fjalën dhe shprehet se dëshiron të vendosë në vëmendje të Këshillit se pjesëmarrja apo prezenca e Avokatit të Popullit dhe roli i tij nuk është një çështje që ka kaluar pa vëmendje nga Këshilli edhe në vitin 2019, edhe në vitin 2020. Janë çështje që kanë filluar të diskutohen që prej shkurtit 2019 kur u hartuan draftet e para të akteve rregullatore dhe institucioni i Presidentit dhe institucioni i Avokatit të Popullit kanë qenë kontribuues në përmirësimin e këtyre akteve në mënyrë të vazhduar. Aty ku ndahej qëndrimi i Institucionit të Presidentit dhe Avokatit të Popullit në raport me qëndrimin e Këshillit, ishin pikërisht edhe ato çështje që u morën në shqyrtim dhe nga Komisioni i Venecias, ku përfshihej dhe prezenca e Avokatit të Popullit gjatë gjithë mbledhjes së Këshillit.

Anëtarët diskutojnë nëse do të debatojnë në parim të gjitha e pastaj në tërësi.

Vitore Tusha merr fjalën dhe shprehet se është dakord edhe me rekomandimin e Komisionit të Venecias në lidhje me faktin që KED-ja duhet të propozojë kandidatë që e kanë kaluar procesin e vetingut, i cili është materializuar dhe reflektuar në nenin 3, 4, 5 të

projektvendimit të propozuar nga grupi i punës, dhe që kanë të bëjnë përkatësisht me ndryshimet në pikat 104, 105 dhe 112 të vendimit nr.4 të lartpërmendur.

Vijohet me votimin e këtyre neneve.

Vitore Tusha hap votimin në tërësi për projektvendimin “Për ndryshimet në vendimin nr. 4, datë 11.03.2019 të KED-së”, në pikat 41, 104, 105 dhe 112.

Të gjithë anëtarët shprehën qëndrimin e tyre që të miratohen. Me 8 vota pro, propozimet miratohen.

- **Pushim**
- **Rifillon mbledhja**

Vitore Tusha vazhdon me pikën tjetër të rendit të ditës që lidhet me shqyrtimin dhe miratimin e projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.5, datë 02.04.2019 të KED-së “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë””.

Saida Dollani e merr fjalën për të relatuar relacionin e grupit të punës. Propozohet që pika 62 e vendimit nr.5, datë 02.04.2019 të KED-së “Për kriteret dhe procedurën e verifikimit, pikëzimit renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” i ndryshuar të ketë këtë formulim: “ Bisedimet e çështjes, si edhe votimi bëhet vetëm nga anëtarët e Këshillit, Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në funksion të transparencës dhe besimit të publikut.

Përmbledhja e procesverbaleve është rekomandimi nr.2 “Përmbledhja e procesverbaleve të të gjitha mbledhjeve të KED-së duhet të publikohet në kohën e duhur”. Është rekomandim i drejtpërdrejtë i dhënë nga Komisioni i Venecies, i cili shprehet, duke thënë: “Argumentet që mbështesin këtë rekomandim lidhen me transparencën që duhet të karakterizojë veprimtarinë e KED-së, qëllimi i së cilës është të sigurojë besimin e publikut në procedurën e zhvilluar nga KED-ja” *shih pikën 91 të kombinuar me pikën 90 të Opinionit.*

Nga analiza e këtij rekomandimi, konstatohet se kuadri rregullator është i plotë dhe nuk ka nevojë për ndryshime. Konkretisht, në nenin 17, pikat 4-6 të vendimit nr. 1, datë 08.02.2019 të KED-së “Për miratimin e rregullores së brendshme për funksionimin e Këshillit për Emërimë në Drejtësi”, i ndryshuar, përcaktohet procedura e përpilimit dhe miratimit të procesverbalit të mbledhjes, që garanton afate të shpejta – dërgimi i menjëhershëm të pjesëmarrësit në mbledhje për shqyrtim; 48 orë për pjesëmarrësit në mbledhje të shqyrtojnë saktësinë e tij; dhe shqyrtimi e miratimi i tij si çështje e parë e rendit të ditës në mbledhjen pasardhëse të Këshillit.

Gjithashtu, në respektim të parimit të transparencës, në pikën 7 të nenit 17 të të njëjtit akt, është parashikuar shprehimisht se: “7. *Procesverbali i përmbledhur, menjëherë pas nënshkrimit nga anëtarët e Këshillit, bëhet publik në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë*”.

Në këtë situatë, Grupi i Punës vlerëson se rekomandimi nr. 2 lidhet me përmirësimin e zbatimit të rregullave ekzistuese, pa pasur nevojën për ndryshime të tyre.

Te rekomandimi nr.3, KED-ja duhet ta miratojë renditjen e kandidatëve vetëm pasi të jenë kompletuar dosjet e të gjithë kandidatëve të listës dhe kryetari i KED-së duhet t’ia dërgojë menjëherë listën së bashku me dosjet përkatëse organeve shtetërore përkatëse pa asnjë vonesë të

mëtejshme. Argumentet që mbështesin këtë rekomandim lidhen me kohën e përcjelljes së listave të renditjes së kandidatëve të vlerësuar nga KED-ja tek organet e emërtesës, kohë e cila u vlerësua nga Komisioni i Venecies si problemi kryesor që shkaktoi incidentin procedural midis Presidentit të Republikës dhe Kuvendit (*shih pikën 92 të Opinionit*).

Në vlerësimin e Grupit të Punës ky rekomandim i përbërë në dy nënrekomandime dhe që për objekt ka eliminimin e çdo vonese në përcjelljen e listës dhe akteve bashkangjitur tek organet shtetërore, mund të reflektohet përmes shtimit të një rregulli të ri dhe ndryshimit të një rregulli ekzistues në vendimin nr. 5, datë 02.04.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi.

Për shqyrtimin e listave përfundimtare të renditjes së kandidatëve tipikisht parashikon pika 70 e vendimit nr. 5, datë 02.04.2019 të KED-së. Kjo pikë e kompozuar në dy nënrenditje a) dhe b) parashikon se Këshilli duhet të verifikojë saktësinë aritmetike të pikëzimit për secilin kandidat (shkronja “a”) dhe renditjen e tyre në listat përfundimtare (shkronja “b”) Në këtë kuptim, pra të verifikimit të akteve, propozohet të plotësohet kjo dispozitë, duke shtuar edhe verifikimin nga Këshilli në lidhje me plotësimin e dosjes së kandidatëve të listës, si dhe që këto dosje të jenë në kopje numerike të mjaftueshme për t’u shpërndarë tek organet e emërtesës.

Sa më lart, grupi i punës propozon që në pikën 70 të vendimit nr. 5, datë 02.04.2019 të KED-së të shtohet shkronja “c” me përmbajtjen si vijon: “Që dosjet e kandidatëve të jenë të plota dhe në kopje të mjaftueshme për t’u shpërndarë tek organet e emërtesës”.

Përcjellja e akteve (lista përfundimtare e renditjes së kandidatëve dhe raporti i arsyetuar i Këshillit për analizën tërësore të plotësimit të kushteve për vlerësimin e kritereve të secilit kandidat) tek organet e emërtesës parashikohet nga pika 76 e vendimit nr. 5, datë 02.04.2019 të KED-së. Sipas kësaj pike është Kryetari që vepron “Menjëherë pas shpalljes së tyre”, me referimin tek listat përfundimtare të renditjes së kandidatëve dhe raportin e arsyetuar. Meqenëse termi “menjëherë” nuk ka specifikimin e domosdoshëm për kërkesat e shpejtësisë së të vepruarit, si dhe, në konsideratë të faktit se bëhet fjalë për afate të veprimeve administrative për të siguruar shpejtësinë e dërgimit të dokumentacionit të kandidatëve të renditur tek organet e emërtesës, propozohet që fjala “menjëherë” të ndryshohet, duke u zëvendësuar me shprehjen “në të njëjtën ditë me shpalljen”.

Rekomandimi nr.5 “Për sa kohë që Gjykata Kushtetuese nuk është funksionale dhe nga aktorët politikë nuk është arritur një konsensus për interpretimin, KED-ja duhet t’ia dërgojë listën/listat Kuvendit sapo Presidenti të ketë proceduar me emërimin/emërimet e tij/saj, ose pas 30 ditësh nëse ai/a jo nuk arrin të veprojë pa shkak”.

“Grupi i punës nuk ra dakord në lidhje me këtë formulim dhe prandaj ju paraqitet në dy versione, por personalisht po paraqes këtu dhe opinionin tim si pjesë e grupit të punës, ky është një rekomandim që nuk është thënë tek KED-ja, pra nuk i rekomandohet KED-së, por organeve ligjvënëse. Është Kuvendi që duhet të parashikojë nëpërmjet një rregulli ligjor, për mendimin tim nuk është që mund të rregullohet me një akt nënligjor, për mendimin tim Komisioni i Venecies ka dhënë opinionin e vet që duhet të jetë ligjvënësi që të shikojë një rregull ligjor në lidhje me sa kërkohet. Por duke qenë se nuk patëm korrkodancë, isha dakord pastaj me atë që tha Marsida që ne t’ia propozojmë njëherë KED-së a ka nevojë apo jo dhe të arrihet në konkluzionin që i takon KED-së të parashikojë njëherë dhe pastaj nëse arrihet në konkluzionin ai është i dhënë në dy variante. Prandaj unë do të propozoja, së pari, që të shikohej nëse i takon KED-së të bëjë një

rregull nënligjor apo nuk është në kompetencat e këtij organi për të vendosur një rregull nënligjor. Pra duke mos pasur një rregull ligjor që t'i japë le të themi në bazë të Kushtetutës”.

Anëtarët dhe anëtarët zëvendësues të Këshillit diskutojnë në lidhje me propozimin e grupit të punës dhe në lidhje me nenin 1 të projektvendimit, pra për shtesat dhe ndryshimet në vendimin nr.5 të KED-së, pika 62. Anëtarët vërejnë se opinioni i Komisionit të Venecias i referohet vetëm pikës 41 të vendimit nr. 4, por nisur nga roli i Avokatit të Popullit, për të ushtruar të drejtën e tij kushtetuese për të marrë pjesë si vëzhgues, për hir të transparencës dhe besimit të publikut në gjithë veprimtarinë e KED-së, konkluzioni i arritur për të ndryshuar pikën 41 të vendimit nr. 4 të KED-së, duhet të reflektohet edhe në pikën 62 të vendimit nr.5 të KED-së.

Gjithashtu, anëtarët diskutojnë në lidhje me rekomandimin tjetër të Komisionit të Venecias, që dosjet e kandidatëve të jenë të plota, që reflektohet në nenin 2 të projektaktit për shtesat dhe ndryshimet në vendimin nr. 5 të KED-së.

Anëtarët dhe anëtarët zëvendësues të Këshillit diskutojnë edhe në lidhje me propozimin e grupit të punës për disa ndryshime në pikën 76 të vendimit nr. 5 të lartpërmendur (neni 3 i projektvendimit), si dhe problematikat që mund të sjellë shprehja e propozuar nga grupi i punës, “në të njëjtën ditë me shpalljen”.

Saida Dollani merr fjalën dhe shton se në një konsultim me anëtarin tjetër të grupit të punës, kishin diskutuar edhe mbi mundësinë që të vihej shprehja “48 orë nga shpallja”.

Anëtarët dhe anëtarët zëvendësues të Këshillit vijnë diskutimin mbi shprehjen “brenda 2 ditëve pune”.

Për sa i përket nenit 4, pra ndryshimet në pikën 80 të vendimit nr. 5 të KED-së, **anëtarët dhe anëtarët zëvendësues të Këshillit** vijnë me diskutimet nëse duhen pranuar ndryshimet në këtë pikë sipas projektvendimit të propozuar nga grupi i punës.

Saida Dollani sqaron se grupi i punës, megjithëse qëndrimi i saj është që nuk i takon KED-së, por ligjvënësit, siç lexohet në pikën 104, pika e 2-të, ra dakord që ta vendosë KED-ja këtë, nëse është një rekomandim për KED-in apo jo, meqenëse në fund të fundit në mënyrë tërthorazi citohet KED-ja “*për sa kohë do të vazhdojë numri i kufizuar në listat e kandidatëve dhe këto lista do të përbëhen nga pothuajse të njëjtët kandidatë, në situatën kur do të duhet të bëhen emërimet në të njëjtën periudhë për më shumë se një raund, Presidenti, Kuvendi dhe Gjykata e Lartë, nëse fillon funksionimin së shpejti, duhet të bien dakord për procedurën që do të ndiqet në përputhje me dispozitat ligjore dhe Kushtetuese dhe KED-ja duhet ta pranojë këtë interpretim, në të kundërt një ose më shumë prej organeve të emërtesës do të rrezikonte të mos ta bënte zgjedhjen mes 3 kandidatëve sikurse kërkohet nga Kushtetuta. I takon Gjykatës Kushtetuese të vendosë për interpretimin e dispozitave të Kushtetutës në një situatë që nuk është parashikuar gjatë procesit të draftimit. Për sa kohë që Gjykata Kushtetuese nuk është funksionale dhe nga aktorët politikë nuk është arritur një konsensus për interpretimin, KED-ja duhet t'ia dërgojë listat Kuvendit sapo Presidenti të ketë proceduar me emërimin/emërimet e tij/saj ose pas 30 ditësh nëse ai/ajo nuk arrin të veprojë pa shkak“ .*

“Pse nuk isha dakord?”

Së pari them, që vet ja rekomandon Presidentit dhe Kuvendit të bien dakord dhe ne si KED jemi të detyruar që sipas marrëveshjes që ka bërë Kuvendi me Presidentin të veprojmë.

Së dyti, nëse Presidenti dhe Kuvendi bien dakord që të futen në dispozitat ligjore, prapë KED-së do t'i duhet të zbatojë ligjin si organ ligjzbatues që është. Kështu që përsëri nuk i takon që të jetë, pra i takon o marrëveshjes së Presidentit dhe Kuvendit, jo por atyre tamam tamam, marrëveshjes së Presidentit dhe Kuvendit dhe nuk i takon KED-së. Kjo ishte arsyeja pse unë mendoja që nuk, duhet një marrëveshje midis Presidentit dhe Kuvendit ata të na i vënë në dispozicion. Kjo është, pra mos ju futur në kompetenca atë që vet Komisioni i Venecias i thotë që jeni ju kompetent, tani... Ja jep, i ka bërë kompetent, pra e rekomandon Presidentin, rekomandon Kuvendin. Kjo është ajo që unë thash. Tani t'ia jap fjalën zonjës Xhaferllari për të shprehur mendimin e saj”.

Marsida Xhaferllari rikonfirmon faktin që nuk është te rekomandimet e drejtpërdrejta të Këshillit për Emërimet në Drejtësi, por lidhet me procedurën e emërimit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. “E mira do të ishte të ishte zgjidhur me ligj. Puna është që Këshilli për Emërimet në Drejtësi ka procedura të nisura, ka procedura të nisura dhe rekomandimi fillon edhe bëhet konkret për këto procedura që janë në shqyrtim nga Këshilli për Emërimet në Drejtësi. Dhe teksa jep hipotezat me radhë që ata duhet të merren vesh, duhet të bëjnë 1 e 2 e 3, fjalja thotë në vijim, i njëjti paragraf që u citua edhe nga gjyqtarja Dollani “*Për aq kohë sa Gjykata Kushtetuese nuk është funksionale*”, pra kuptohet që bëhet fjalë për këtë moment që jemi ne tani “*dhe për aq kohë sa nuk është arritur konsensus*”, pra duhet të veprojmë përderisa ata nuk merren vesh, se po të merreshin vesh e bënin ligjin, e miratonin e sillnin dhe ne do të kishim gjetur zbatim”.

Konsensusi mund të jetë miraton ligjin, konsensusi mund të jetë edhe të vijmë përfaqësuesit këtu dhe thotë. Po pra, thotë KED-ja DUHET të dërgojë listën, kjo është domethënë dhe sa i takon pastaj versioneve, e tha edhe Saida që kemi pas diferenca, versioni 1 është hartuar nga unë, versioni 2 është hartuar nga Saida, unë di t'ju them që te versioni që është përdorur, kam përdorur, këtu flitet sipas rekomandimit”.

Anëtarët dhe anëtarët zëvendësues të Këshillit vazhdojnë diskutimin mbi këtë çështje, si dhe **për terminologjinë** që duhet të përdoret.

Saida Dollani pyet zotin Dervishaj nëse ka një marrëveshje ndërmjet organeve të emërtesës.

Bledar Dervishaj sqaron se me ardhjen e opinionit nga Komisioni i Venecias ka pasur një takim midis Kryetarit të Kuvendit dhe Presidentit të Republikës, ku veç diskutimeve u ra dakord për ngritjen e një grupi për të diskutuar paraprakisht në nivel teknik për ecurinë e mëtejshme të zbatimit të rekomandimeve. “Në atë grup pune jam caktuar unë nga Presidenti dhe ende nga Kuvendi nuk na është njoftuar deri më sot personi që do të përfaqësojë Kuvendin në këtë takim. Pra, deri më sot nuk ka ndonjë takim apo marrëveshje për të cilën ju pyesni dhe as jemi ulur që të diskutojmë.

Është shumë e vështirë për mua të jap një mendim në këto momente kur nuk është prezent dhe përfaqësuesi i Kuvendit këtu dhe ende nuk kemi një diskutim apo dakortësim. Por shkak për atë incident procedural e përplasje institucionale në mënyrë të padiskutueshme që ishte dërgimi i listave tek organet e emërtesës. Ndaj Këshilli përmes akteve rregullatore do të duhet të ketë një mekanizëm zhblllokues të vetin. Në fund të ditës, mekanizmi zhblllokues është edhe për Këshillin. Dhe unë propozimin e lidh edhe me pikën 76, ku u vendos, siç tha Zonja Tusha, 48 orë për të dyja. Por kur do të bëhet vlerësimi i njëjës vakancë dhe i tjetrës vakancë? A mos ka nevojë pika 76 për një shtesë paragrafi, që të parashikojë që në rastet për të zgjidhur

ngërçet, Këshilli të shprehet me vendim ku bashkë me pikëzimin, të vendosë edhe mënyrën e dërgimit të listave? Ky mund të ishte rregull për Këshillin, për të mos i dhënë fuqi detyruese, por në varësi të situatës, të kishte mundësinë për vendimmarrje rast pas rasti, me qëllim zhbllokimin e situatës. Pra Këshilli, të mos ngelet në varësi të asaj marrëveshje midis organeve të emërtesës por të ketë mundësi që në çdo rast të zhbllokojë situatën.

Anëtarët diskutojnë për një ndryshim te pika 76 e vendimit nr. 5 të KED-së.

Erinda Ballanca sqaron se është një çështje e cila mund të duket në momentin e parë abstrakte, pra ashtu lexohet: në qoftë se nuk është kaluar njëherë ushtrimi, pra në qoftë se nuk është bërë njëherë ushtrimi i vlerësimit dhe i identifikimit të verifikimit të kriterëve dhe më pas i vlerësimit dhe dërgimit të listave, atëherë duket sikur është një gjë e pamundur për t'u realizuar. “Në momentin që është bërë njëherë ky ushtrim dhe është parë sesi funksionon në praktikë, kuptohet që del nevoja e rregullimit domosdoshmërisht të këtij fakti. Si do ta rregullojmë? A do ta rregullojmë me këtë normë? Ndoshta kjo jo. A do ta rregullojmë me një *guide line*, pra me një udhëzim të mëtejshëm, siç e propozoi zonja Tusha ndoshta apo zoti Dervishaj, ndoshta do të ishim aty. Këshilli duhet të ketë qartësinë që në momentin në të cilin do të shpallë listën, do të jetë Këshilli ai që do përcaktojë edhe mënyrën e dërgimit, sepse Këshilli, aty në atë moment do të gjejë, do të kuptojë cila do të jetë problematika e asaj dërgese në atë rast. Pra, mundet të ketë një numër të vogël kandidatësh, mundet të ketë një numër minimal, mund të jenë të njëjtët kandidatë, pra mundet të ketë nevojë që lista e dytë ngrihet apo lista, domethënë në një listë janë 3 veta, por ne duhet të garantojmë që edhe kur t’ia çojmë Kuvendit të ketë 3 veta, të paktën 3 dhe prandaj them që kjo çështje duhet të trajtohet nga Këshilli në çdo vendim në momentin përfundimtar kur të dërgohet lista sipas problematikës eventuale që mund të ketë apo jo ajo listë.

Radha do të jetë, nuk është radha domosdoshmërisht President – Kuvend, mund të jetë radha kush e ka sjellë i pari, mund të jetë dhe kjo një problem tjetër.

Ideja është që mund ta shpallë më vonë. Diskutimi që unë kam në rastin konkret është që qëllimi duhet të jetë i qartë që KED-ja duhet ta ndiejë veten si pjesë e një organizmi, grupi organesh që kanë për detyrë të bëjnë emërimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Detyra e KED-së është të furnizojë organet e emërtesës me sa më shumë kandidatë dhe në një mënyrë që t’ia bëjë sa më të mundshme përzgjedhjen organeve të emërtesës. Pra, a ka mundësi KED-ja të dërgojë emra të ndryshëm dhe sa më shumë kandidatë, të listojë sa më shumë kandidatë? Kjo do të ishte idealja, ky do të ishte qëllimi. A duhet t’ia dërgojë KED-ja listat në një mënyrë që t’ia vështirësojë punën organeve të emërtesës? Jo. Kjo gjë ndodhi në KED-në e mëparshme dhe prandaj ndodhi gjithë ky konflikt shumë i madh institucional. Unë mendoj që të paktën në rregullore në këtë moment, edhe për koshiençë institucionale të këtij organi, ne të shënojmë që mënyra sesi do t’i dërgohen organeve të emërtesës listat të jetë e tillë që të mundësojë për **organet emërimin në detyrë, në përputhje me ligjin**, pra duhet të tentojmë *time line-n* edhe frymën them unë.”

Bledar Dervishaj shton se ky rekomandim i pikës 104 përfshin të gjitha institucionet, por ka disa kushte kumulative, jo që të plotësohen të gjitha, por i specifikon Venecia që është rast pas rasti, kur ka pak kandidatë. “Sot kemi kandidatë, por ne nuk e dimë nëse do të jenë kandidatë deri në fund, dhe sa prej tyre do të kualifikohen e sa jo. Trysnia e të pasurit kandidatë mund të rritet shumë. A e zgjedh Presidenti? Një nga arsytet që unë mbaj mend që ne vendosëm pezullimin, ishte pikërisht të ruanim Kuvendin që të kishte tre kandidatë, se po të zgjidhnim dy njëherazi ia zbrisnim të dyja listat nën numrin e nevojshëm të kandidatëve. Jo vetëm ia zbrisnim

Kuvendit, por jua zbrisnim juve (KED) duke pamundësuar edhe vet dërgimin e listave tek Kuvendi. Kështu që le të jenë të njëjtët por të shikojmë lista se ne tani i kemi listat, ka shumë emra të njëjtë. E treta është nuk biem dakord. A është ky momenti për të caktuar Këshilli një rregull për vete, detyrim?

A është momenti? Jo, jo, detyrimi buron, detyrimi i këtij rekomandimi erdhi nga veprimet, tani mos t'i kthehemi më. Por që Këshilli duhet t'i krijojë hapësirën vetes me një rregull që në varësi të gjendjes, sipas rekomandimeve të Venecias, të gjejë mundësinë që të mos e krijojë më këtë problematikë ose mos të lërë hapësirë që të krijohet një incident tjetër procedural.

Edhe rekomandimi zbatohet, edhe ne ndërkohe gjatë kësaj faze që unë nuk e di se kur, do ndërkohe që ju mund të vazhdoni me vlerësimin e kandidaturave, do të kemi hyrë në diskutime me Kuvendin dhe do të shprehemi edhe këtu në mbledhje të KED, se është detyra jonë, e para e Presidentit, dhe Kuvendit të themi që “po ne diskutuam, kemi arritur në këtë logjikë....”.

Tani po diskutohet në parim. Këshilli do të gjendet me këto lista, janë psh. 51 kandidatë që do i vlerësoj. Do mundet KED t'i vlerësojë në një ditë? Dhe kur të vendosë Këshilli, do të thotë vendosa pikëzimin sipas kësaj renditje? Pezullimin e procesit të dërgimit të listave? E bën Këshilli se e ka hapur rrugën Venecia dhe e ka bërë dhe herë tjetër pezullimin e procesit deri sa të shprehet. Ja p.sh. pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave që ka vënë në lëvizje Presidenti i Republikës për të rivlerësuar shpalljen e thirrjes nëse do ta vazhdojë me dy zgjedhje, e mbani mend vendimin e KED vitin e shkuar për vakancën e Presidentit ?

Dhe në të njëjtën logjikë do të vijmë sërish. Kështu që ajo është logjikë që ju po e konsolidoni tani në një rregull të përgjithshëm. Për t'i lënë hapësirë Këshillit për vendime sipas fenomenit të shfaqur, më mirë se sa për një rregull strikt që duket sikur i fut dhe organet e emërtesës në një shtrëngesë...”.

Saida Dollani shton se duhet parë me kujdes. Organit të emërtesës i jep kompetencat që ka, nuk i futet fare në kompetenca. Unë për veten time këtë ide kam që organit të emërtesës të mos i futesh fare në kompetenca, jo për t'i përplasur.

Bledar Dervishaj shton se “ne kemi një situatë faktike që të tria vakancat janë vakanca të parakohshme. A ju përkasin dy cikleve? Ju përkasin dy cikleve. Pra, janë plotësuar kushtet që thotë Venecia. Dhe Venecia e dinte shumë mirë gjëndjen kur bëri renditjen e vakancave në faqen 3 të raportit se cilat janë pritshmëritë për të ndodhur. **Prandaj u tregua e kujdesshëm**”.

Anëtarët dhe anëtarët zëvendësues të Këshillit diskutojnë mbi mundësinë e një shtese dhe ndryshimi në pikat 70 dhe 75 të vendimit nr. 5 të lartpërmendur.

Vitore Tusha shton se është më mirë të lihet e fundit si pikë diskutimi dhe miratimi dhe të kalohet në miratimet e tjera. Hapet votimi në tërësi për projektvendimin “Për ndryshimet në vendimin nr. 5, datë 02.04.2019 të KED-së”, në pikat 62, 70 dhe 76 me shprehjen “brenda 2 ditë pune”.

Të gjithë anëtarët shprehën qëndrimin e tyre duke miratuar ndryshimet. Me 8 vota pro këto propozime miratohen.

Vitore Tusha propozon të bëhen 5 minuta pushim që të reflektohet propozimi i fundit.

Rifillon mbledhja

Largohet zonja Erinda Ballanca.

Fiona Papajorgji – E merr fjalën për të relatuar. “Propozimi në bazë të dakortësisë me pothuajse të gjithë anëtarët e Këshillit ishte që në pikën 70 të vendimit nr. 5 të KED-së, pas pikës “b” të shtohet edhe pika “c” me këtë formulim: “Mënyrën e përcjelljes së listës përfundimtare organeve të emërtesës”. Kjo pikë për më tepër qartësi flet për çfarë shqyrton Këshilli në momentin që kemi një listë përfundimtare, d.m.th pika do të bëhet “Këshilli shqyrton listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve dhe të paraqitur nga relatori për të verifikuar: a) saktësinë aritmetike të pikëzimit total për secilin kandidat sipas vendimit përkatës të vlerësimit; b) renditjen e tyre në listat përfundimtare sipas totalit të pikëve të dhëna, si dhe kur është rasti të kushteve të treguara në piken 69; c) që dosjet e kandidatëve të jenë të plota dhe në kopje të mjaftueshme për t’u shpërndarë tek organet e emërtesës; d) mënyrën e përcjelljes së listës përfundimtare organeve të emërtesës. Këtu jemi në fazën e shqyrtimit të listave përfundimtare, prandaj u mendua që dhe në piken 75 të vendimit 5, që lidhet me vendimin e Këshillit, të bëhet një plotësim, pra një shtesë. Pika 75 pas shtesës të jetë “Vendimet e Këshillit për vlerësimin dhe pikëzimin e secilit kandidat, listat përfundimtare të renditjes së kandidateve, mënyrën e përcjelljes së tyre organeve të emërtesës dhe raportin e arsyetuar që i dërgohet organit të emërtesës, shpallen brenda afatit ligjor 10-të ditor nga dita e fillimit të kësaj procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve”. Pra do të shtohet shprehja “mënyrën e përcjelljes së tyre organeve të emërtesës” pas fjalëve “renditjes së kandidatëve”.

Anëtarët dhe anëtarët zëvendësues diskutojnë edhe një herë për këtë propozim. Të gjithë anëtarët shprehin qëndrimin e tyre që të miratohet. Me 8 vota pro, ky propozim miratohet.

Vitore Tusha e merr fjalën duke sqaruar: “Atëherë u miratua neni 1, neni 2 dhe neni 3 në unanimitet, po ashtu u miratuan plotësimet në nenet 70 dhe 75, siç u paraqitën, duke u shtuar shprehje që u përmendëm dhe gjatë shqyrtimit të listave Këshilli vlerëson dhe për mënyrën e dërgimit të listave dhe po ashtu vendimi do të përmbajë në pjesën arsyetuese edhe mënyrën e dërgimit të listave. Gjithashtu dua të them diçka që u përmend nga Saida mos gaboj në fillin në lidhje me proces-verbalet është një rekomandim tjetër që lidhet me përmbledhjen e proces-verbaleve dhe publikimin e tyre është parë nga grupi punës është parë i gjithë norma. Gjithë aktet normative janë parë dhe nuk vërehet që ka vend për ta reflektuar sepse lidhet kryesisht me veprimtarin me zbatueshmërin e këtyre akteve në këtë kuptim unë mendoj që i kemi plotësuar ose i kemi impelmentuar gjithë rekomandimet që lidhen edhe në mënyre të drejtpërdrejt me rregullin e nenit 41 për transparencën dhe që lidhet me pjesëmarrjen e Avokatit të Popullit. Çështjen që lidhet me procesverbalet do të përpiqemi maksimalisht që ta realizojmë me gjithë vështirësitë e vërteta që ka për procedurë që ta realizojmë me ndihmën e stafit administrativ dhe po ashtu kemi marrë me konsideratë rekomandimin për dërgimin e listave bashkë me dosjet përkatëse kompetente shtetërore dhe në lidhje me procesin e vetingut, mendoj që i kemi marrë në konsideratë dhe i kemi implementuar në aktet normative.”

Saida Daollani shton gjithashtu se nga grupi i punës u vlerësuar edhe në lidhje me një rekomandim të gjashtë “e kemi thënë dhe nr. 6-të edhe si grup pune dhe bëhet fjalë për koherencën ku është shkruar që koherenca gjithashtu duhet të sigurohet edhe në procedurën e betimit të kandidatëve nga jashtë gjyqësorit të kryera nga KED-ja procesi nuk duhet të rezultojë në paralizimin e institucioneve gjyqësore. Ky rekomandim gjendet në paragrafin 83 të opinionit të komisionit të Venecias si pjesë e analizës që i është bërë procedurave të vlerësimit kalimtar ku vihet në dukje nevoja për përsheptim dhe racionalizim të këtij procesi”.

Largohet zonja Artta Marku.

Saida Dollani vazhdon fjalën e saj: “Nëse do të interpretohet në mënyrë të ngushtuar ky rekomandim, atëherë duhet të thuhet që KED-ja duhet të sigurojë që procedurat e verifikimit për kandidatët e jogjyqësorit të bëhet në mënyrë të shpejtë dhe të racionalizuar nëse koncepti i koherencës do të zgjerohet, atëherë do të duhet që KED-ja të bashkëpunojë me organet e vlerësimit për të shmangur situatat kur të dyja këto organe kushtetuese veprojnë me procedura paralele dhe për të **njëjtat subjekte me rrezikun e rezultateve të kundërta, siç mund të jetë rasti kur kandidati gjyqtari është i lidhur me një subjekt rivlerësimi. Mënyrat e bashkëpunimit mund të realizohen përmes shkëmbimit të ndërsjellë të informacionit dhe përmes kërkesave për përsheptim të procesit. Gjithsesi, kjo çështje mbetet në vlerësim të KED-së dhe për këtë ne nuk kemi as një lloj formulimi, sepse ngelet në vlerësim të KED-së për t’u mbajtur në konsideratë gjatë zbatimit.**

Është një sugjerim parimor që ka të bëjë dhe në lidhjen mendoj unë së subjekti është dhe në betimi qoftë dhe Këshilli t’i japë autorizimin kryetarit për t’ju drejtuar KPK –së apo KPA-së për të përsheptuar procesin që mos të ketë. Është më tepër si një udhëzim se sa të ketë nevojë për një akt nënligjor”.

Vitore Tusha informon se Presidenti i Republikës dhe Kryetari i Kuvendit kanë përcjellë një shkresë me datën e sotme në lidhje me plotësimin e vakancave në Gjykatën Kushtetuese, ku inkurajojnë dhe mbështesin veprimtarin e KED-së që të veprojë sa më shpejt. Gjithashtu, Kuvendi ka paraqitur edhe opinionin e përkthyer nga ekspertja, përkthyesja zyrtare Adelina Ibrahim, pas vërejtjeve që u bënë në mbledhje e shkuar.

Bledar Dervishaj merr fjalën duke sqaruar se: letra e Presidentit e sapombërritur në KED nuk besoj se është lexuar nga të gjithë anëtarët, sepse “letra ka ardhur pasi mbledhja e Këshillit kishte nisur. Të dy këto letra qoftë e Presidentit, qoftë e Kryetarit të Kuvendit e datës 9, që është administruar sot në datën 10 dhe jemi njohur dhe ne, vijnë në vazhden pas takimit të realizuar mes Presidentit të Republikës dhe Kryetarit të Kuvendit në mbështetje për ecjen përpara dhe vijimin e veprimtarisë së KED pa ndërprerje dhe sa më shpejt të procesit të verifikimit vlerësimit dhe pikëzimit të kandidaturave për plotësimin e vakancave në Gjykatën Kushtetuese që gjenden sot në Këshill. Këto letra janë në frymën e mbështetjes dhe në frymën e shfaqjes së vullnetit të tyre. Kryetari i Kuvendit ka evidentuar në letrën e tij se çfarëdo lloj pengese t’i shfaqet Këshillit në këtë proces t’ia bëjë me dije Kuvendit të Shqipërisë për të bërë të mundur kapërcimin e çdo lloj pengese. Në të njëjtën logjikë është dhe letra e Presidentit të Republikës për mbështetjen e KED. Unë si përfaqësues i Presidentit shpreh dhe një herë se këto akte që ju miratoni sot do të bëhen publike në Fletoren Zyrtare sepse janë akte rregullatore. Pas botimit dhe hyrjes në fuqi të tyre, Këshilli duhet të vlerësojë mundësinë që sa me shpejt të kalojë

në fazën tjetër të verifikimit dhe relatimit për dy vakancat që presin, dhe që herën e kaluar relatorët cituan se për disa vakanca jemi gati. Kështu që ne mirëpresim gjithashtu një informacion të përgjithshëm. Nëse keni informacion shtesë, ne e mirëpresim dhe e marrim. Mbështetje janë për Këshillin të dy këto akte (*shkresa e Kryetarit të Kuvendit dhe shkresa e Presidentit të Republikës*)”.

Vitore Tusha, pas diskutimeve me anëtarët për rendin e ditës, cakton se mbledhja do të jetë në datën 17.07.2020, ora 13:30 dhe në rend të ditës do të jetë shqyrtim i dy vakancave, me relatorë zonjën Arta Marku dhe zonja Saida Dollani.

Bledar Dervishaj pyet nëse ka pasur plotësime të dokumentacionit të ardhur nga institucionet e treta, për vakancën e tretë që i përket Presidentit të Republikës.

Vitore Tusha sqaron se lidhur me institucionet që nuk janë përgjigjur, janë bërë këto veprime: u është ridërguar kërkesa për informacion së bashku me kërkesën e parë. Gjithashtu u është bërë kërkesë partive politike për të marrë informacion.

Miranda Andoni vë në dukje se nuk ka skaduar afati brenda të cilit duhet të kthejë përgjigje.

Bledar Dervishaj sqaron se herën tjetër do të jenë më të qartë në lidhje me informacionin.

Vitore Tusha vë në dukje që nëse do të ketë institucione që nuk përgjigjen, do të kërkojë patjetër ndihmë institucionale.

Saida Dollani sqaron se është një kërkesë ligjore dhe nëse ligji do të zbatohet për çdo gjë, kjo futet në kuadrin e zbatimit të ligjit, nuk thuhet asgjë që është e jashtëligjshme.

Vitore Tusha vë në dukje se ka gjithë procedurën që është ndjekur për këtë gjë dhe ju rekomandon relatorëve të komunikojnë me këshilltaret dhe për mes tyre të komunikohet me kandidaten që të përcillet relacioni në datën e fiksuar për mbledhjen.

Vitore Tusha deklaron të mbyllur mbledhjen.

Tiranë, më 10.07.2020

SEKRETARE

Ermelinda KADIU

Dorina DULAJ

Elona KARDHIQI

Fabjola MUHAMETI

Vilma DOKUSHI

Zv/KRYETARE

Vitore TUSHA